



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR 20/06/ 2025			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	062015		23082

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



PROCESVERBAL

I

TUBIMIT TË PARË ME PUBLIKUN

Datë: 19.06.2025
Ora: 11:00
Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Tubimi me publikun në lidhje me aktivitetet e komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, u mbajt me datë 19 qershor 2025. Këtë tubim e hapi **Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun**, z. Bekim Dobra, dhe të pranishëm ishin:

Ramiz Lladrovci	Kryetar i Komunës
Endrit Gllareva	Drejtor i Drejtorisë për Infrastrukturë Lokale
Laureta Thaqi	Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
Petrit Gashi	Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Agnesë Kastrati-Bucolli	Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, dhe UD e Drejtoreshës së Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
Muhamet Gjoka	Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim
Lumnije Krapit	Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Arian Krasniqi	Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Albulena Saliuku	Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Herolindë Krasniqi	Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
Kushtrim Bajraktari	Zyrtari Kryesor Financiar [ZKF]



Në këtë tubim me publikun, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, z. Bekim Dobra, i cili gjithashtu e moderoi tubimin, ju drejtua të pranishmëve dhe i informoi për rrjedhën e takimit. I nderuari Kryetar i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, Drejtorë të drejtorive komunale, Anëtarë të Kuvendit të Komunës, Administratorë të fshatrave, Përfaqësues të lagjeve dhe organizatave joqeveritare, Të nderuar qytetarë.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbajë dy tubime me publikun gjatë vitit: një gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit fiskal – pra, ky që po mbahet sot – dhe një tjetër në fund të vitit.

Për këtë tubim, Komuna ka bërë njoftimin me kohë dhe e ka publikuar dy javë më parë në ueb-faqen zyrtare, në rrjetet sociale të Komunës, si dhe në të dy hyrjet e objektit të Komunës dhe në mediat online.

Të nderuar të pranishëm,

Ndjej për obligim t’ju njoftoj për rregullat e këtij takimi:

Tubimi me publikun ka karakter informues. Përfaqësuesit e Komunës do t’ju informojnë për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, për të arriturat dhe sfidat, si dhe për synimet dhe investimet kapitale të planifikuara për gjysmën e dytë të vitit. Ju, të pranishëm, keni të drejtë të bëni pyetje dhe të jepni propozime drejtuar përfaqësuesve të zgjedhur komunalë, lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara dhe çështje të tjera me interes për qytetarët.

Për të elaboruar shkurtimisht aktivitetet e Komunës gjatë gjashtëmujorit të parë, për sukseset dhe sfidat, ftoj Kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci, të marrë fjalën.

Lidhur me projektet dhe aktivitetet e realizuara, si dhe ato që janë në planifikim për t’u realizuar gjatë këtij viti.

Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, falënderoi qytetarët për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre në të mirë të interesit të përgjithshëm dhe të komunitetit, duke theksuar rëndësinë e kontributit të tyre për mbarëvajtjen e punës së institucionit komunal. Ai vlerësoi gatishmërinë e qytetarëve për të ndarë nevojat, vërejtjet dhe ankesat, por edhe për të ofruar mendime rreth cilësisë së shërbimeve dhe projekteve të realizuara.



Në veçanti, falënderoi administratorët e vendbanimeve për angazhimin dhe bashkëpunimin e pandërprerë me ekzekutivin komunal në realizimin e objektivave të përbashkëta dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Ai u bëri thirrje që të vazhdojnë të jenë bashkëpunues dhe mirëkuptues, kritikë kur është e nevojshme, por edhe mirënjohës për përpjekjet që po bëhen për të mirën e përbashkët.

Gjithashtu, falënderoi drejtorët e kabinetit për përkushtimin dhe zbatimin e punëve të planifikuara, për menaxhimin e buxhetit dhe për respektimin e afateve të investimeve në projektet kapitale.

Ndër të tjera, Kryetari iu drejtua të pranishmëve me këtë fjalim:

Të nderuar qytetarë të Drenasit,

Të nderuar administratorë të vendbanimeve,

Ju faleminderit për pjesëmarrjen në këtë tubim me publikun.

Komuna e Drenasit, me të gjitha kapacitetet e saj, është e angazhuar për realizimin e projekteve të planifikuara sipas buxhetit të miratuar nga Kuvendi Komunal, si dhe për adresimin e kërkesave që mund të paraqiten ndërkohë.

Falënderoj të gjithë qytetarët për bashkëpunimin dhe përkushtimin e tyre ndaj të mirës së përgjithshme dhe të komunitetit. Vlerësojmë kontributin tuaj për mbarëvajtjen e punës sonë përmes njoftimit me nevojat, vërejtjeve, komenteve mbi cilësinë e punëve të kryera dhe ankesave të arsyeshme.

Sot, në veçanti, dëshiroj të falënderoj administratorët e vendbanimeve, të cilët, pa kursyer kohën dhe angazhimin e tyre, kanë bashkëpunuar ngushtë me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta për mirëqenien e qytetarëve, të vendbanimeve, lagjeve dhe familjeve të tyre.



Të nderuar të pranishëm,

Gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportojmë, komuna jonë ka qenë një vendpunishte e vazhdueshme. Po realizohen shumë projekte infrastrukturore. Rrugë dhe rrugica janë asfaltuar dhe do të asfaltohen gjithandej komunës, pa përjashtim, gjithmonë sipas planifikimit të paraparë. Rrjeti i kanalizimit është përfunduar në shumicën e vendbanimeve.

Nuk do të hyj në detaje për secilën rrugë apo projekt, pasi lista është e gjatë. E dimë se kemi ende shumë punë për të bërë – dhe nuk do të ndalemi. Ju ftoj që të vazhdoni të jeni bashkëpunues e mirëkuptues, kritikë kur duhet, por edhe mirënjohës për atë që së bashku po arrijmë në shërbim të qytetarëve tanë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë gjashtëmuor, pjesëmarrësit parashtruan kërkesa, ofruan sugjerime dhe dhanë komentet e tyre.

Kërkesat e parashtruara, sugjerimet dhe komentet e dhëna kryesisht u bënë nga:

Zekë Kluna	Administrator i fshatrave Poklek i Ri, Poklek i Vjetër dhe Vasilevë
Hasan Elshani	Banor i fshatit Gllobar
Kadri Ajazi	Administrator i fshatrave Sankoc dhe Fushticë e Ulët
Habib Gashi	Administrator i fshatit Nekoc
Xhafer Dobërdolani	Administrator i fshatit Korroticë e Epërme dhe Zabel i Epërm
Nasuf Elshani	Banor i fshatit Gllobar
Qerim Bërbatovci	Përfaqësues i fshatit Godanc
Imri Bajraktari	Administrator i fshatit Kizharekë
Besim Nishori	Administrator i Komoran 1 dhe 2
Arben Istogu	Administrator i fshatit Polluzhë
Jahir Beqiri	Administrator i Drenasit 1
Shaban Berisha	Banor i fshatit Gllanasellë



Kërkesat e parashtruara nga të lartpërmendurit ishin kryesisht të natyrës së ngjashme, duke përfshirë ndriçimin publik, infrastrukturën rrugore (mirëmbajtjen, shtrimin dhe asfaltimin e rrugicave dhe trotuareve), ujësjellësin dhe kanalizimin, ndërsa komentet përmbanin kryesisht përgëzime për punën e deritanishme.

Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e paraqitura në formë tabelore:

Lloji:	Total:	Statusi:
Kërkesa	12	Pranohen
Përmbajtja	Përgjigje	
• Ndriçimi publik, • Infrastrukturë rrugore [mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve], • Ujësjellës [shtrimi i gypave, lidhjet], dhe • Kanalizim [Sanimi i ujërave të zeza mbi sipërfaqe].	Të gjitha kërkesave të parashtruara, kryetari i komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci në bashkëkoordinim me drejtoritë përkatëse u dha përgjigje, duke theksuar se: • Ndriçimi publik është pothuajse i përfunduar. Tashmë është përzgjedhur kompania fituese e tenderit, e cila do të vendosë ndriçimin edhe në ato pak lokacione që kanë mbetur. • Infrastruktura rrugore - është në drejtimin e duhur; punimet po zhvillohen me intensitet të lartë dhe të gjitha projektet po realizohen sipas planifikimeve të urbanizimit. Përjashtim bëjnë disa projekte, të cilat janë ndikuar nga shkurtimet buxhetore në disa kode, si pasojë e zbatimit të kontratave kolektive dhe obligimeve përmbartimore. • Ujësjellësi - shumica e punimeve janë përfunduar nga komuna; janë instaluar gypa dhe pompa të reja. Megjithatë, ka ende disa sfida në disa fshatra, të cilat pritet të zgjidhen së shpejti si rrjedhojë e problemeve me rrjetin ekzistues të gypave të vjetërsuar. • Kanalizimi - Projekti është në fazën përfundimtare. Ekzistojnë disa pengesa, por ato janë nën kontroll dhe pritet të menaxhohen me sukses. Sa i përket prishjes së gypave dhe rrjedhjes së ujërave të zeza në sipërfaqe, drejtoria përkatëse do të ndërmarrë masat e nevojshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje.	



Lloji:	Total:	Statusi:
Sugjerime	2	Pjesërisht pranohen
Sugjerimet	Përgjigje	
• Pastrimi i degës së lumit Drenica, në segmentin nga fshati Kizharekë deri në Komoran dhe nga Gryka e Gashit deri në fshatin Kizharekë. • Ndërtimi i murit mbrojtës, nga varrezat e fshatit Kizharekë deri te udhëkryqi i lagjes Sylaj. • Hapja e rrugës nga Gryka e Kizharekës deri te vendi i quajtur “Shkolla e Maleve”, në zonën e Maleve të Berishës. • Krijimi i parkut rekreativ te Pishat e Komoranit.	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës: Të gjitha projektet e sugjeruara – pastrimi i degës së lumit Drenica, ndërtimi i murit mbrojtës, hapja e rrugës drejt “Shkollës së Maleve” në Malet e Berishës, si dhe krijimi i parkut rekreativ te Pishat e Komoranit, janë të mirëpritura dhe me interes të madh për komunën tonë. Do të angazhohemi që, në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse, t’i shqyrtojmë me prioritet këto sugjerime dhe t’i përfshijmë në planifikimet buxhetore dhe zhvillimore të radhës. Nëse ka mundësi brenda kapaciteteve aktuale financiare dhe teknike, do të fillojmë me implementimin e tyre sa më shpejt.	

Lloji:	Total:	Statusi:
Komente	2	Pranohen
Komente	Përgjigje	
• Është një model për punën, transparencën dhe korrektësinë edhe për komunitet të tjera. • Deri më tani keni bërë një punë të shkëlqyer dhe uroj që edhe në të ardhmen të vazhdoni po njësoj.	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës: Falënderoj administratorët e vendbanimeve që përkrahin kohën, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta dhe mirëqenien e qytetarëve. Kërkoj po ashtu të jenë si deri më tani, bashkëpunues por edhe mirëkuptues, të jenë ankues por edhe mirënjohës që së bashku po e bëjmë më të mirën për qytetarët tanë.	



Pas përfundimit të sesionit të kërkesave, pyetjeve, sugjerimeve dhe komenteve në kuadër të këtij tubimi, Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, njëherësh edhe moderator i tubimit, z. Bekim Dobra, e shpalli tubimin të mbyllur. Ai gjithashtu i kujtoi të pranishmit se së shpejti do të mbahen dëgjimet buxhetore nëpër këshillat lokale.

Tubimi me publikun u përmbyll në orën 12:30.



Procesmbajtësi:

Artion Hasani
Artion Hasani





Shtojca - 1

Procesverbalit i janë bashkëngjitur edhe dokumentet në vijim:

Faqe	Emërtimi
9	Paraqitja e pjesëmarrësve në formë tabelore
10	Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e Parë me Publikun
11	Njoftimi në gjuhën shqipe
12	Njoftimi në gjuhën serbe
13 - 14	Lista e pjesëmarrësve në Tubimin e Parë me Publikun
15 - 23	Foto nga Tubimi i Parë me Publikun



Paraqitja e pjesëmarrësve në formë tabelore



Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e parë me Publikun

Ftesa dhe njoftimet përcjellëse lidhur me Tubimin e Parë me Publikun janë publikuar edhe në kanalet zyrtare të Komunës së Drenasit, gjithmonë brenda afateve të përcaktuara ligjore.

Vegëzat:

- Ueb-faqja zyrtare e Komunës:** <https://gllogoc.rks-gov.net/news/njoftim-per-qytetaret-e-komunes-se-drenasit-11/https://gllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Tubimi-me-publikun-per-daten-19.06.2025-shqip-dhe-serbisht.pdf>
- Platforma Qeveritare për Konsultime Publike:** <https://konsultimet.rksgov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42833>
- Faqja zyrtare në Facebook:** <https://www.facebook.com/share/p/1EG9jC9L8k/>



Njoftimi në gjuhën shqipe

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		05/06/ 2025	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	20786	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 18 pika 1, 4, 5. 5.1, 5.2., pika 6, 7,8 dhe 9 të Rregullores Komunale për Transparencë si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci:

ORGANIZON Tubim me publikun

Të enjten më datën **19.06.2025** duke filluar në orën **11:00**.

Tubimi me publikun do të mbahet në **Sallën e Kuvendit** dhe ftohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara të Komunës, të marrin pjesë në këtë Tubim Publik duke ju përmbajtur terminin të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e parë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt!


KRYETARI I KOMUNËS
Ramiz Lladrovci



Njoftimi në gjuhën serbe



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit

KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	05/06/2025		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	06d/01	20786	



Na osnovu člana 68, Glava IX – Direktna demokratija i mehanizmi učešća građana, tačke 68.1, 68.2 i 68.3 Zakona o lokalnoj samoupravi, članova 21, 22, 23, 24 i 25 Statuta Opštine Drenas, tačke 1, 4, 5, 5.1, 5.2, 6, 7, 8 i 9 člana 18. Opštinske uredbe o transparentnosti, kao i člana 17. Administrativnog uputstva za otvorenu administraciju u opštinama, Predsednik Opštine Drenas, Ramiz Lladrovci:

ORGANIZUJE

Javnu tribinu sa građanima

U petak, dana **19.06.2025.** godine, sa početkom u **11:00** časova.

Javna tribina će se održati u **Sali Skupštine**, a pozivaju se svi građani i zainteresovani subjekti Opštine da prisustvuju ovom javnom događaju, u skladu sa navedenim terminom.

Na ovoj javnoj tribini, predstavnici Opštine će obavestiti prisutne o aktivnostima Opštine tokom prve polovine tekuće godine, dostignućima, izazovima i ciljevima, kao i o kapitalnim investicijama. Učesnici će imati priliku da postave pitanja i iznesu predloge izabranim opštinskim predstavnicima u vezi sa sprovođenjem planiranih projekata za prvo polugodište i drugim pitanjima od interesa za građane Opštine.

Sa poštovanjem,



Predsednik Opštine
Ramiz Lladrovci



Lista e pjesëmarrësve ne Tubimin e Parë me Publikun



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas-Municipality of Drenas



Lista e pjesëmarrësve në Tubimin e parë me Publikun, datë: 19.06.2025

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Nënshkrimi
1.	Nasuf	Elshani	M.	Nasuf Elshani
2.	Hasan	Elshani	M	Hasan Elshani
3.	IBRAHIM	MORINA	M	Ibrahim Morina
4.	Blerta	Berisha	F	Blerta Berisha
5.	REUSTEM	BUBLAKU	M	Reustem Bublaku
6.	SHABANI	PAERISAA	M	Shaban Paerisaa
7.	QERIM	BERBATOV	M	Qerim Berbatov
8.	BEJRI	NISHORI	M.	Bejri Nishori
9.	ZENË	KLUPA	M	Zenë Klupa
10.	Hasan	Merisha	M	Hasan Merisha
11.	ARBON	ISTOGU	M	Arbon Istogu
12.	Arben	Hazin	M	Arben Hazin
13.	Edi Bregu	Bregu	M	Edi Bregu
14.	Murat Elshani	ELSHANI	M	Murat Elshani
15.	KAORI	Ajazi	M	Kaori Ajazi
16.	Imri	BAJRAKARI	M	Imri Bajrakari
17.	XHAFER	DORËDOLAKI	M	Xhafer Doredolaki
18.	Therodet	Krasniqi	M	Therodet Krasniqi
19.	Arben	Zeku	M	Arben Zeku
20.	Haris	Gashi	M	Haris Gashi
21.	Adrim	Proshi	M	Adrim Proshi
22.	Ibrahim	Hydri	M	Ibrahim Hydri
23.	SHABAN	DORR	M	Shaban Dorr
24.	Enver	Hoxha	M	Enver Hoxha
25.	Besir	Basani	M	Besir Basani
26.	Haris	Hasani	M	Haris Hasani

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



27.	AYOYL	MZIU	M	<i>[Signature]</i>
28.	ERLIND	KEASNIQI	M	<i>[Signature]</i>
29.	ARTON II	HASANI	M	<i>[Signature]</i>
30.	Albulena	Salihën	F	<i>[Signature]</i>
31.	Nexhmedin	Gruda	M	<i>[Signature]</i>
32.	PETKIT	GASHI	M	<i>[Signature]</i>
33.	Agnesë	Kastrati - Bucolli	F	<i>[Signature]</i>
34.	Lumnige	Gjorhi - Krapci	F	<i>[Signature]</i>
35.	Muhamet	Gjoka	M	<i>[Signature]</i>
36.	Arjan	Krasniqi	M	<i>[Signature]</i>
37.	LAURETA	THAQI	F	<i>[Signature]</i>
38.	ENORIT	GLUKONJA	M	<i>[Signature]</i>
39.	KUSHTRIM	BAJRAKTARI	M	<i>[Signature]</i>
40.	Ramiz Hadrore		M	<i>[Signature]</i>
41.	AFIJE	VESELI	F	<i>[Signature]</i>
42.	Sadete	Zeriqi	F	<i>[Signature]</i>
43.	Gentiane R	Klaim	F	<i>[Signature]</i>
44.	Rinore	Zymeri	F	<i>[Signature]</i>
45.	MARIGONA	QORRI	F	<i>[Signature]</i>
46.	Arlinda	Rukaj	F	<i>[Signature]</i>
47.	Leonora	Jhala	F	<i>[Signature]</i>
48.				
49.				
50.				
51.				
52.				
53.				
54.				
55.				
56.				
57.				
58.				
59.				
60.				
61.				
62.				

* Në këtë takim, përveç kësaj liste, do të bëhen fotografi dhe, me nënshkrimin tuaj, pajtoheni që fotografitë dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



Foto nga Tubimi i Parë me Publikun

















